



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr. 2361, datë 27.09.2013**

**Për**

***Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Altelecom sh.a. dhe Albanian Mobile Communications sh.a. në lidhje me procesin e portimit të numrave nga Albanian Mobile Communications sh.a. drejt Altelecom sh.a.***

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 27.09.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Altelecom sh.a. dhe AMC sh.a. në lidhje me procesin e portimit të numrave nga Albanian Mobile Communications sh.a. tek Altelecom sh.a.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 88, neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);

2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, e ndryshuar;
4. Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, ndryshuar;

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 5087/4Prot., datë 10.9.2013 “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje në lidhje me procesin e portimit të institucionit D.R.S.K.SH Korçë nga operatori AMC në rrjetin Albtelecom”.
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 4954Prot, datë 19.8.2013, “Në lidhje me procesin e portimit të institucionit D.R.S.K.SH. Korçë nga operatori AMC në rrjetin e Albtelecom”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 5087Prot, datë 26.8.2013, “Mbi moszbatimin e portabilitetit të numrit nga operatorët Plus dhe AMC”
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 5087/1Prot, datë 29.8.2013, “Në lidhje me procesin e portimit të institucionit D.R.S.K.SH. Korçë nga operatori AMC në rrjetin e Albtelecom”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 5087/2Prot, datë 30.8.2013, “Në lidhje me procesin e portimit të institucionit D.R.S.K.SH. Korçë nga operatori AMC në rrjetin e Albtelecom”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 5087/3Prot, datë 3.9.2013, “Në lidhje me procesin e portimit të institucionit D.R.S.K.SH. Korçë nga operatori AMC në rrjetin e Albtelecom”;
- Korrespondenca me postë elektronike e shkëmbyer mes palëve dhe AKEP gjatë periudhës: 15.8.2013 – 4.9.2013;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**),

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

- I. Albtelecom sh.a. me shkresën me nr. 5087/4Prot., datë 10.9.2013 ka paraqitur pranë AKEP “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje në lidhje me procesin e portimit të numrave të institucionit D.R.S.K.SH Korçë nga operatori AMC në rrjetin Albtelecom”.

Albtelecom sqaron se mosmarrëveshja midis Albtelecom dhe AMC ka filluar me dërgimin e kërkesës për portim nga Albtelecom për subjektin DRSKSH Korçë në datë 15.8.2013. Të gjitha kërkesat e dorëzuara janë refuzuar nga AMC me arsyen: “Name and

*surname does not match*". Me emailin e datës 16.8.2013, AMC shpjegon se kanë hasur probleme teknike për shkak të arritjes së maksimumit ditor të numrit të kërkesave "port – out". Nga AMC, pavarësisht ndërhyrjeve të përditshme dhe kërkesës për bashkëpunim të Albtelecom, nuk ka patur reagim apo bashkëpunim për korrigjimin e te dhënave të kërkesës për bartje. Gjithashtu edhe refuzimet e kërkesave për bartje nga AMC janë kyertej afateve të përcaktuara në nenin 15/3 të Rregullores së portabilitetit të numrit.

AKEP më datë 19.8.2013 me anë të email-it i ka kërkuar AMC të bashkëpunojë me Albtelecom për zgjidhjen e rastit, por sërish nuk ka patur asnjë përgjigje nga AMC.

Edhe pas email-it të AKEP, situata vazhdon të jetë e njëjtë dhe nuk ka reagim nga AMC. Albtelecom shpjegon se janë 915 pajtimtarë të cilët kërkojnë t'u realizohet shërbimi i portabilitetit të numrit nga AMC.

Më datë 21.8.2013 AKEP thirri palët në takim për diskutimin e çështjeve në mosmarrëveshje. Edhe në takim palët vazhduan të mbanin të njëjtin qëndrim si në pretendimet e sjella më parë.

Albtelecom sqaron se pavarësisht ndërhyrjes së AKEP, situata vazhdon të jetë pezull dhe nga AMC nuk kemi shpjegim për vonesat, përveç problemeve teknike.

Albtelecom thekson se AMC gjatë gjithë procesit të portimit të subjektit DRSKSH Korçë ka vepruar në shkelje të nenit 5/1, nenit 12/2, nenit 15/2 e 3, nenit 17/2 të rregullores së portabilitetit.

Mosrealizimi i portimit të subjektit DRSKSH Korçë prej datës 15.8.2013 i ka shkaktuar dëme të konsiderueshme operatorit Albtelecom jo vetëm në dëmtim të imazhit të tij për sa i përket ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit ndaj pajtimtarit por edhe duke krijuar kosto shtesë operationale që nuk do të ishin nëse çdo operator do të zbatonte kuadrin rregullator në fuqi për këtë proces.

Sa më lart, Albtelecom në zbatim të nenit 17, të Rregullores së portabilitetit dhe nenit 120 të ligjit nr. 9918, i kërkon AKEP lëshimin e Urdhërit me Vendim të Këshillit Drejtues për detyrimin e AMC për të portuar të gjithë numrat e DRSKSH Korçë në rrjetin e Albtelecom.

Albtelecom kërkon kompensimin nga AMC të dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar të Albtelecom si pasojë e kësaj mosmarrëveshje.

Duke qenë se sipërmarrësit Albtelecom sh.a. dhe Albanian Mobile Communications sh.a. megjithë përpjekjet e bëra edhe me ndërhyrjen e AKEP, nuk kanë arritur të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis tyre, për sa i takon procesit të portimit të numrave nga Albanian Mobile Communications sh.a. tek Albtelecom sh.a. AKEP, në zbatim të nenit 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, nenin 46 e vijues të K.Pr.A,

## **V E N D O S:**

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe AMC sh.a. në lidhje me procesin e portimit të numrave nga Albanian Mobile Communications sh.a. drejt Albtelecom sh.a.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
  - Shefqet Meda Kryetar
  - Donald Shtrepi Anëtar
  - Dritan Malaj Anëtar
  - Esmeralda Dervishi Anëtar
  - Ded Jakaj Anëtar
1. Të njoftohen palët e interesuara Albtelecom sh.a. dhe AMC sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
2. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

## **K R Y E T A R E**

**Alketa MUKAVELATI**

## **ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Elkeda DOMI**
4. **Zamira NURÇE**